



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 133, Datë 07.06.2018

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ÇAUSHI - ENERGJI” SH.P.K. PËR  
MODIFIKIMIN E LICENSËS SË “PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE” NR.  
181, SERIA PV12K, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË  
KOMISIONERËVE TË ERE-S NR 122, DATË 29.08.2012**

Në mbështetje të neneve 16, dhe 43, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; VKM nr. 365, datë 04.05.2011 “Marrëveshje Kocensionare me Nr. 5446 Rep; nr. 1944 Kol, datë 02.05.2011”, të ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE mbledhjen e tij të datës 07.06.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për modifikimin e licencës së shoqërisë “ÇAUSHI - ENERGJI” sh.p.k., përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

**Konstatoi se :**

- Shoqëria “ÇAUSHI - ENERGJI” sh.p.k, është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qafëzezë” me fuqi të instaluar 400 kW, me vendimin e bordit të ERE nr. 122, datë 29.08.2012.
- Me shkresën me nr. 312 Prot., datë 11.04.2018, shoqëria “ÇAUSHI - ENERGJI” sh.p.k, ka paraqitur në ERE një kërkesë për modifikimin e licencës aktuale nr. 181, Seria PV12K për “Prodhimin e Energjisë Elektrike” nga Hec “Qafëzezë”, me fuqi të instaluar 400 kW, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 122, datë 29.08.2012.
- ERE me vendimin nr. 95, datë 20.04.2018, vendosi fillimin e procedurave “Për modifikimin e licencës së shoqërisë “ÇAUSHI -ENERGJI” sh.p.k me nr. 181, Seria PV12K për “Prodhimin e Energjisë Elektrike” nga Hec “Qafëzezë”, me fuqi të instaluar 400 kW.

Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “ÇAUSHI - ENERGJI” sh.p.k, në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton si më poshtë:

- Informacioni me shkrim ku janë spjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (neni 15, pika 4, gërma “a”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (neni 15, pika 4, gërma “b”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera (neni 15, pika 4, gërma “c”). Aplikuesi ka paraqitur: Kontratë Shtesë “Për disa ndryshime dhe shtesa në Kontratën e Konçesionit (nr. 2452 Rep., nr. 307 Kol., datë 24.07.2009) të formës “BOT”, për ndërtimin e Hec “Qafëzezë”, mbajtur në datën 21.02.2017, me nr 529 Rep., nr. 201/1 Kol., midis MEI si Autoritet Kontraktues dhe shoqërisë “CAUSHI/K” sh.p.k. me cilësinë e Koncesionarit.
- Ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi (neni 15, pika 4, gërma “d”), janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Plotësimi i pagesave të rregullimit në ERE (neni 15, pika 4, gërma “e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Nuk janë paraqitur nga subjekti leja mjedisore dhe leja e shfrytëzimit të ujrave, të lëshuara nga organet kompetente për fuqinë e instaluar 1450 kW.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “ÇAUSHI - ENERGI” sh.p.k., për modifikimin e licencës me nr. 181, Seria PV12K, për “Prodhimin e Energjisë Elektrike” nga Hec “Qafëzezë”, me fuqi të instaluar 400 KW, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 122 datë 29.08.2012, me kushtin që brenda 3 muajve nga marrja dijani e këtij vendimi, të depozitohet në ERE lejen mjedisore dhe lejen e shfrytëzimit të ujrave, të lëshuara nga organet kompetente për fuqinë e instaluar 1450 kW.
2. Në rastin e mospërbushjes së këtij kushti nga ana e subjektit, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi.
3. Fuqia e instaluar në Hecin “Qafëzezë”, nga 400 kW bëhet 1450 kW.
4. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s..

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**